



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 316/24

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 23.06.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari



Në bazë të nenit 20 pika 3 të Ligjit Nr. 06/-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, Kryetari i Komunës me datën 20.03.2024 merr këtë:

### V E N D I M PËR THEMELIM TË KOMITETIT TË AUDITIMIT

1. Themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
  - 1.1 z. Shyqyri Hyseni, kryesues i komitetit
  - 1.2 z. Sahit Surdulli, anëtar
  - 1.3 z. Arben Mlinaku, anëtar
2. Mandati i anëtarëve të Komitetit të Auditimit është 3 vjet nga dita e emërimit.
3. Komiteti, detyrat e tij do të i kryej konform dispozitave të Ligjit në fuqi për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe Udhëzimin Administrativ nr. 01/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik,.
4. Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës është sekretar i Komitetit të Auditimit i cili do të ndjek të gjitha takimet e Komitetit.
5. Komiteti i Auditimit duhet të mbledhet së paku 4 herë në vit, por Kryesuesi mund të thërrasë mbledhje shtesë sipas nevojës.
6. Për çdo takim të Komitetit të Auditimit, sekretari mban procesverbalin dhe shënimet gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet e diskutuara. Procesverbalet mbahen në NJAB në pajtim me dispozitat ligjore apo nënligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje.
7. Komiteti i Auditimit përgatitë Raportin vjetorë për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik.
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

#### Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komitetit të Auditimit
- Drejtorit të NJAB
- Arkivit



Ferit Idrizi  
Kryetar i Komunës

REPublika e Kosovës - Republika Kosovo  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 344 / 24

Nr. i fq. / Br. sf \_\_\_\_\_

Data: / Datum 08.04.2024

VUSHTRRI - VUÇITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe nenin 2 të Rregullores (KKV) Nr.01/22, nr. protokollit 157/22, datë 30.06.2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 03/2020 datë 27.02.2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat, Kryetari i Komunës merr këtë:

### V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi i fermerëve të Komunës së Vushtrrisë me nga 0.05 € (pesë cent) për litër qumësht të dorëzuar në pikat grumbulluese ose direkt në qumështore.
2. Pagesa të bëhet për 103 (njëqind e tre) fermerë të komunës së Vushtrrisë të cilët janë të përfshirë në listën e Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural datë 11.01.2024, bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi, e që janë përfitues të këtij subvencionit. Sasia e qumështit që subvencionohet: 1575132 litra, vlera për pagësë e subvencionit: 78,756.60 € (shtatëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë cent).
3. Pagesat të kryhen nga mjetet buxhetore (subvencione dhe transfere) të Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



**Erir Idrizi**

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRAN

02 Nr. / Br 348/24

Nr. i fq. / Br. sf \_\_\_\_\_

Data: / Datum 11.04.2024

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRAN  
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 04 qershor 2008), nenin 25 par. 1 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 19 datë 21.07.2022), Udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, shkresën njoftuese të MAPL-së nr. 0-893, dt. 15.11.2023, si dhe propozimin e kryesuesit të grupit punues për përgatitjen e planit të Integritetit për periudhën 2024-2026, Kryetari i Komunës merr,

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIM TË PLANIT TË INTEGRITETIT PËR VITET 2024-2026**

1. Miratohet Plani i Integritetit të Komunës së Vushtrisë për vitet 2024-2026.
2. Për mbikëqyrje të implementimit të Planit të Integritetit do të caktohet zyrtari përgjegjës i Komunës me vendim të veçantë i cili do të raportoj në baza vjetore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.
3. Plani i Integritetit i miratuar mund të rishikohet (ndryshohet) në përputhje me nevojat, zhvillimin dhe interesat e institucionit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Integritetit 2024-2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe drejtoritë komunale.
6. Ky vendim si dhe Plani i Integritetit për vitet 2024-2026 i dërgohet për njoftim Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.





REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 462/24

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 26.04.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 dhe 51 paragrafi 3 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIM TË DREJTORISË PËR DIASPORË**

1. Temelohet Drejtoria për Diasporë në kuadër të administratës së Komunës së Vushtrrisë.
2. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Diasporë do të përcaktohen në aktin e brendshëm për organizimin e administratës së komunës të miratuar nga Kryetari i Komunës.
3. Drejtoria do të ushtroj gjithashtu përgjegjësit konform legjislacionit të zbatueshëm.
4. Kryetari i Komunës me vendim do të emëroj drejtorin e Drejtorisë për Diasporë.



Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Personelit
- Arkivit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr./ Br 466/24

Nr. i fq./ Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 29.04.2024

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI  
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës dhe nenin 4 paragrafi 3 të Rregullores (KKV) Nr. 03/23, prot. Nr. 49/23 datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ-ve dhe Ndhimë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport 03Nr. 290/24 datë 24.04.2024, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Klubit të Hendbollit "Vushtrria" meshkujt, i lejohet mbështetje financiare nga buxheti i komunës në shumë prej 500.00 € (pesëqind euro) për mbulim të shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve sportive, për shkak të vështirësive financiare me të cilat ballafaqohet ky klub.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi të paguhen nga Buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria subvencione dhe transfere, në llogari bankare të këtij klubi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

*Ferit Idrizi*  
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- Arkivit